



*Dimensionet e vrimave të shpuara në minierë kanë gjatësi deri 200 cm. Grafikat paraqesin modele të ndryshme të shpuarjeve.





HAPËSIRA TË PËRPJEKJES POLITIKE:
MINIERA E TREPÇËS 1989

Me nacionalizimin e vitit 1948, Trepça u bë shpejt një nga minierat më të rëndësishme në industrinë minerare të Jugosllavisë. E udhëhequr nga punëtorët me prejardhje të ndryshme kulturore, subvencionet dhe investimet shtetërore në infrastrukturën dhe teknologjinë minerare përgjatë tre dekadave, rritën prodhimin dhe përmirësuan kushtet e punës. Si rezultat, kjo solli një përfshirje më të madhe të punëtorëve shqiptarë dhe vendosjen e tyre në role menaxheriale. Për më tepër, prodhimi më i lartë i mundësoi Trepçës të krijojë lidhje të reja ekonomike dhe të negociojë rrugën e saj në tregtinë e jashtme.



Propozimet e paraqitura në vitin 1988 për ndryshimet në Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974, suprimonin autonominë e Kosovës. Të vetëdijshëm për pushtetin e tyre ekonomik, minatorët e Trepçës organizuan marshin nga Mitrovica në Prishtinë më 17 nëntor, 1988, për të ofruar mbështetjen e tyre udhëheqësve shqiptarë në Lidhjen Komuniste të Kosovës dhe për të kundërshtuar heqjen e autonomisë. Marshi nuk dha rezultate. Përkundrazi, në muajt në vijim kriza politike vëtëm sa u thellua.

Më 20 shkurt, 1989, me ndryshimet kushtetuese pranë ratifikimit, minatorët hynë në grevë. Minatorët e ndërrimit të katërt nuk dolën nga zgafella. Më vonë gjatë ditës iu bashkua ndërrimi i parë, i dytë dhe i tretë. Nëntoka ishte hapësira e përpjekjeve të tyre politike dhe një lokacion nga ku ata krijuan një marrëdhënie tjetër me atë që ishte duke ndodhur politikisht mbi tokë. Ata ishin të vendosur të mos largoheshin nga zgafella derisa të plotësoheshin kërkesat e tyre. Gjatë tetë ditëve të grevës, ata qëndruan në horizontin e tetë dhe të nëntë të minierës së Trepçës.

Kërkesat e minatorëve nuk ishin sociale por politike dhe si të tilla kërkonin një zgjidhje politike. Udhëheqës të shumtë të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë i vizituan përgjatë grevës për të diskutuar kërkesat e tyre. Nga dhjetë kërkesa, tre prej tyre trajtonin arsimin e lartë, përfaqësimin politik dhe autonominë e vendit. Gjegjesisht, minatorët ishin kundër pensionimit të parakohshëm të stafit akademik shqiptar, shkarkimit të përfaqësuesve politikë dhe suprimimit të autonomisë së Kosovës. Këto të drejta ishin arritur plotësisht me Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974.

Struktura organizative e grevës ishte horizontale, andaj dhe nuk kishte udhëheqës. Me qëllim të sulmimit të pozicionit politik të minatorëve dhe përpjekjeve të tyre për të kundërshtuar ndryshimet në kushtetutë, trembëdhjetë minatorë dhe punëtorë të menaxhmentit të Trepçës, një ish-përfaqësues politik si dhe drejtori i atëhershëm i KEK-ut u veçuan. Një ditë pas përfundimit të grevës, më 1 mars, 1989, ata u burgosën për katërmëdhjetë muaj për veprimtari irredentiste dhe kundërrevolucionare. Gjithashtu, 1300 minatorëve grevistë u është shqiptuar dënimi dhe të njëjtit janë përndjekur politikisht. Për shkak të thellimit të ndarjes përgjatë vijave etnike, minatorët u dënuan me 30 ose 60 ditë burg, varësisht nga kombësia e gjyqtarëve. Avokatët anembanë Jugosllavisë dolën vullnetarë për t'i përfaqësuar ata në gjykatë.

Me hyrjen e minatorëve të Trepçës në grevë, jeta ekonomike e vendit pothuajse u shua. Shumë ndërmarrje shtetërore kishin ndërprerë prodhimin, pasi që punëtorët e tyre mbështetnin kërkesat e minatorëve. Kërkesat e grevës gjithashtu frymëzuan solidaritet dhe aleanca ndërklasore. Mirëpo, më e rëndësishmja, kauza e tyre mori vëmendje në të gjithë hapësirën jugosllave dhe arenën ndërkombëtare.



MBI EKSTRAKTIMIN

Mbretëria e Jugosllavisë ia dha Mbretërisë së Bashkuar minierën e Trepçës nga viti 1927 deri në 1977. Kontrata pesëdhjetë-vjeçare me koncesion i siguroi asaj autoritet të plotë për të hulumtuar, mihur dhe eksportuar xehet e minierës së Trepçës. Përbrenda Mbretërisë së Jugosllavisë, Kosova nuk kishte autonomi mbi resurset e saj natyrore. Ekspertët shkencor britanez erdhën në Kosovë dhe sollën me vete një model ekstraktivist të zhvillimit, i cili ua mundësoi eksplotimin e lëndës së parë. Modeli ekstraktivist gjeneroi benefite të pakta për ekonominë lokale. Përballë shtypjeve të ndërthurura, e privuar nga autonomia e saj dhe burimet natyrore, Kosova asokohe nuk ushtronte asnjë formë të agjencisë politike për të kundërshtuar këtë marrëdhënie eksploatuese.

9 dhjetor, 1927


Miniera e Trepçës ishte regjistruar si kompani aksionare me rreth 7500 aksionarë, me emrin Trepca Mines Limited me bazë në Londër.

Trepca Mines Limited menaxhohej nga Selection Trust, e cila ishte pjesë e Central European Mines Limited, kompani që menaxhonte një rrjet të minierave në Evropën Qendrore dhe Lindore.

FIG.1 Çertifikata e regjistrimit të kompanisë TrePCA Mines Ltd. në Londër. Dokumente nga arkivi i Foreign Office - Public Records Office. Dauti, Daut. "Lufta për Trepçën (sipas dokumenteve britanike)", botuar nga KIEAI, Prishtinë, 2002, f. 155.

DUPLICATE FOR THE FILE.

No. 226478




Certificate under s. 87 (2) of the Companies (Consolidation) Act, 1908 (8 Edw. 7, c. 69), that a Company is entitled to commence business.

I hereby Certify, That the

TREPCA MINES LIMITED

which was incorporated under the Companies Acts, 1908 to 1917, on the ninth day of December 1927, and which has this day filed a statutory declaration in the prescribed form that the conditions of s. 87-1 (a) and (b) of the Companies (Consolidation) Act, 1908, have been complied with, is entitled to commence business.

Given under my hand at London this twenty-second day of December One Thousand Nine Hundred and twenty-seven.


Registrar of Joint Stock Companies.

Certificate received by Commission for Business
of Great Britain
1882.

Date 28/12/27

17 gusht, 1930

Në Stantërg filloi mihja intensive e xeheve. Kapaciteti i ekstraktimit ishte njëqind tonelata xehe në orë. Përbërja e plumbit për një tonelatë xehe ishte 69.7%, argjend 24.4%, ari 0.049% unca.

Selection Trust hapi zyre dhe laboratore hulumtimi, po ashtu bleu 70 hektarë tokë për të ndërtuar plantacionin dhe koloninë për punëtorët e administratës, inxhinierët e minierës, një pjesë e madhe e të cilëve ishin anglezë dhe rusë.

Investimet kapitale në industrinë minerare në Mbretërinë e Jugosllavisë deri në fund të vitit 1937 ishin investime të huaja. Nga investimet e përgjithshme, investimet e Mbretërisë së Bashkuar ishin 41% dhe Francës 28%.








FIG. 2, 3 dhe 4: Harta gjeologjike dhe gjeografike të rajonit ku shtrihen xehet e minierës së Trepçës. Dokumente nga arkivi i *Foreign Office - Public Records Office*. Dauti, Daut. "Lufta për Trepçën (sipas dokumenteve britanike)", botuar nga KIEAI, Prishtinë, 2002, f. 160, 161, 162.



TREPÇA MINES LIMITED
GENERAL LAYOUT
OF
PLANT







13 korrik, 1938

Trepca Mines Ltd. dhe Banka Popullore e Jugosllavisë kishin nënshkruar marrëveshjen e cila rregullonte çmimin dhe eksportin e xeheve. 70% të xeheve shiteshin brenda vendit dhe çmimi i tyre përcaktohej nga Ministria e Xeheve dhe Metalurgjisë së Mbretërisë së Jugosllavisë, ndërsa 30% eksportohej dhe çmimi përcaktohej nga Trepca Mines Ltd.

12 korrik, 1939

3600 punëtorë të Trepçës kishin hyrë në grevë. Miniera kishte pushuar së punuari për shkak të kushteve jo të mira të punës. Kushte më të mira ishin premtuar gjatë grevës së 14 majit, 1936 në Tunelin e Parë dhe Stantërg. Kjo grevë kishte zgjatur plot 19 ditë.

Pas tre viteve, pak çka kishte ndryshuar. Andaj, menaxhmenti me bazë në Londër dhe Beograd ishte detyruar të nënshkruaj një marrëveshje më të volitshme për punëtorët.




FIG. 5: Tubimi i punëtorëve të Trepçës, 12 korrik 1939, pak para grevës së madhe të xehëtarëve. Libri “Rilindja 1945–1985 (Tekste për monografi)”, redaktuar nga Ali Sutaj, 1985, f. 45.



30 shtator, 1939

Nga hulumtimet e realizuara në dhjetë-vjeçarin e parë u vlerësua që në Trepçë kishte 6 milionë tonelata xehe rezervë, me përbërje 8.7% të plumbit dhe 3.8% të zinkut.


FIG. 6: Skicë e sistemit të makinës shpuese. Vrimat e shpuara ishin 200 cm të gjata, si dhe 160 deri 180 cm. Nga fondi i Trepçës 1927-1939. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës.





This 6 HOLES TO BE DRILLED 200 CM LONG
all the rest from 160cm to 180cm Long

Me ndërtimin e shkrites së plumbit, në fund të vitit 1940 filloi shkrirja me një kapacitet prej 20 mijë tonelata në vit të metaleve të rafinuara, siç ishin zinku, argjendi, kloridi i zinkut dhe bizmuti metalik.

FIG. 7: Bllokdiagrami i vendburimeve të mineraleve në minierën e Trepçës.







8 prill, 1941

Britania e Madhe i tërheq punëtorët anglezë nga Kosova, të cilët asokohe ishin kuadro profesionale të Kompanisë Trepça.

20 prill, 1941

Kompania Trepça u mor nën kontrollin e Gjermanisë naziste dhe u bë pjesë e Wehrmacht Luftwaffe, e cila ishte nën pronësinë e Hermann Göring, zyrtar i lartë në administratën e Hitlerit. Me okupimin e Mbretërisë së Jugosllavisë, si dhe pjesës veriore të Kosovës nga nazistët, miniera e Trepçës ishte shndërruar në kamp të punës së detyrueshme. Rrethanat e pafavorshme gjatë Luftës së Dytë Botërore kishin bërë që menaxhimi i kompanisë Trepça të mos diskutohej në qarqe diplomatike.

20 prill, 1941

Musolini pranoi një raport të detajuar mbi pronat e Trepçës. Në të shkruante, që nëse Italia do të merrte nën kontroll minierën e Trepçës, do të bëhej eksportuesja kryesore e plumbit dhe zinkut në Evropë. Gjermanët insistonin që ta kontrollonin rajonin ku ndodhej miniera dhe gjithashtu linjën hekurudhore ndërmjet Mitrovicës dhe Kaçanikut. Më pas, Italia dhe Gjermania u dakorduan që Prishtina të merrej nën kontroll nga Italia, kurse Mitrovica nga Gjermania, dhe personeli i linjës hekurudhore të jetë gjerman.

20 nëntor, 1944

Gjermania naziste tërhiqet nga Stantërgu i Mitrovicës. Gjatë okupimit tre-vjeçarë, 1941–1944, ata kishin shkatërruar shkretorën, shfrytëzuar koncentratet e mineraleve, makineritë, mjetet e transportit, ndërtesat dhe nuk kishin bërë mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre.

8 dhjetor, 1944

Menaxhmenti i Trepçës përfundimisht ishte transferuar nga nazistët gjermanë tek partizanët jugosllavë.

25 qershor, 1945

Central European Mines Ltd., pjesë e së cilës ishte edhe Trepca Mines Ltd., iu drejtua me një letër Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë të Britanisë së Madhe, ku kërkonte që të sqarohet statusi i investimeve britanike në Jugosllavi. Ata ishin përgjigjur shpejt dhe i kishin siguruar që niveli më i lartë i shtetit po merrej me këtë çështje, gjegjësisht kryeministri Winston Churchill.

4 korrik, 1945

Në Kongresin e Parë të Sindikatave në Jugosllavi, në fjalimin e tij, Josip Broz Tito kishte apeluar tek punëtorët që të gjitha mjetet e prodhimit duhej të ishin në duart e tyre dhe të mos pajtoheshin që ato të mbesin në pronësi private. Tutje, ai kishte shtuar se pa klasën punëtore dhe pa atë fshatare, shteti demokratik dhe federativ i Jugosllavisë nuk mund të bëhej. Paradigma e re ekonomike, që nuk favorizonte profitin privat dhe kishte në qendër klasën punëtore, rrezikonte investimet britanike në Jugosllavi.


23 dhjetor, 1948

Pas orvatjes tre-vjeçare, përfundon procesi i nacionalizimit të minierës së Trepçës. Çështja e investimeve britanike në Jugosllavi përmbillet me Marrëveshjen Anglo-Jugosllave për Kompensim. Shuma e kompensimit për të gjitha investimet britanike në Jugosllavi ishte 4.5 milionë funta.

31 dhjetor, 1960

Pas kompensimit të 7500 aksionarëve, kompania Trepca Mines Limited me bazë në Londër, zyrtarisht pushon së ekzistuari.

FIG. 8: Fotografi e Monumentit të Minatorëve në Mitrovicë e punuar nga arkitekti jugosllav Bogdan Bogdanović në vitin 1973. Libri, "Bogdan Bogdanović: Memoria und Utopie in Tito-Jugoslawien", redaktuar nga Ivan Ristić, botuar nga Architekturzentrum Wien, Austri, 2009, f. 79.



Në vitin 1973, Bogdan Bogdanović, arkitekti i shquar jugosllav, komisionohet të konceptojë Monumentin e Minatorëve në Mitrovicë.

Monumenti nga betoni u ngrit në kujtim të revoltës së minatorëve, të cilët më 30 korrik, 1941 hodhën në erë teleferikun që përdorej për transportin e xeheve nga miniera e Stantërgut në shkretoren e Zveçanit. Kjo shkretore furnizonte industrinë e armatimit të nazistëve.

FIG. 9: Studim antropomorf i shtyllave të Monumentit të Minatorëve në Mitrovicë nga Bogdan Bogdanović më 1960, Thëngjill në letër transparente, 24,5 x 22,2 cm, Pastel në letër. Libri, "Bogdan Bogdanović: Memoria und Utopie in Tito-Jugoslawien", redaktuar nga Ivan Ristić, botuar nga Architekturzentrum Wien, Austri, 2009, f. 81.




FIG. 10: Studim i formës abstrakte të atlasit, skicë e Monumentit të Minatorëve në Mitrovicë nga Bogdan Bogdanović më 1963, 29,5 x 21 cm, Stilolaps në letër. Libri, "Bogdan Bogdanović: Memoria und Utopie in Tito-Jugoslawien", redaktuar nga Ivan Ristić, botuar nga Architekturzentrum Wien, Austri, 2009, f. 80.





FIG. 11: Skicë për ide rreth Monumentit të Minatorëve në Mitrovicë nga Bogdan Bogdanović më 1965, Thëngjill në letër transparente, 20,4 x 31,5 cm. Libri, “Bogdan Bogdanović: Memoria und Utopie in Tito-Jugoslawien”, redaktuar nga Ivan Ristić, botuar nga Architekturzentrum Wien, Austri, 2009, f. 80.



FIG. 12: Skicë e formës së Monumentit të Minatorëve në Mitrovicë nga Bogdan Bogdanović më 1970, 39 x 58,6 cm. Libri, “Bogdan Bogdanović: Memoria und Utopie in Tito–Jugoslawien”, redaktuar nga Ivan Ristić, botuar nga Architekturzentrum Wien, Austri, 2009, f. 81.



1960–1981

Pavarësisht borxheve që kompania Trepça kishte, kjo periudhë konsiderohet të jetë Periudha e Artë e Trepçës. Punësimi, direkt dhe indirekt, u zgjerua masivisht dhe sipas standardeve lokale pagesa ishte e kënaqshme. Gjatë kësaj periudhe, ndërmarrjes së Trepçës iu shtuan një varg fabrikash nën menaxhimin e saj. Njëkohësisht, Trepça përfitonte nga Fondi federativ për zhvillimin e krahinave dhe republikave më pak të zhvilluara.

FIG. 13: Fotografi nga vizita e Mahmut Bakallit, asokohe Kryetar i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, në minierën e Trepçës. Fotografia është nga arkivi privat i Mahmut Bakallit. Rreth viteve '70-të.





11 mars, 1981


Një pjatë u thye në menzën e studentëve të Universitetit të Prishtinës për të shprehur pakënaqësinë me kushtet jo të mira të studentëve. Ngjarja i dha krahë një demonstratë masive të organizuar nga studentët e Universitetit të Prishtinës. Kërkesa për ushqim dhe kushte më të mira në konvikte ishte simbolikë e kërkesës për trajtim të barabartë të shqiptarëve në Jugosllavi. Dy javë më vonë, në ceremoninë e pritjes së Shtafetës së Rinisë, studentët mbanin pankartën “Për kë punon Trepça?”. Trepça konsiderohej gjigant ekonomik në Jugosllavi, gjë që e bënte vështirë të shpjegueshme varfërinë ekonomike të Kosovës përbrenda saj.

Për kë punon Trepça?


1981–1985

Gjatë kësaj periudhe shqiptarët përbënin 67.9% të forcës punëtore në minierën e Trepçës dhe madje dominonin në organizatat shoqërore të tjera që ishin nën menaxhimin e saj. Megjithatë, ata ishin të nënpërfaqësuar në pozita të larta menaxheriale, të cilat kryesisht mbaheshin nga serbët.

FIG. 14-18: Najdeski, Dimče, dhe Zvicer, Mihailo. "Kosovo", botuar nga shtëpia botuese e gazetës "Borba", Boal Ekonomska Politika, gazeta Jedinstvo dhe Boal Publishing, Prishtinë, 1982.






















28 shtator, 1983

Xhavit Bajraktari dhe Shyqri Miftari, që të dy minatorë të minierës së Trepçës, kishin shkruar pesëmbëdhjetë parulla në muret e menzës së punëtorëve. Parullat ishin “Kosova Republikë!” “Trepça është e jona!” “Poshtë tradhtarët!” Gjithnjë në rritje ishin zërat që shprehnin pakënaqësi rreth asaj se kush përfiton nga Trepça. Përkundër faktit që përfitimet e Trepçës raportoheshin si të mëdha, shqiptarët në Kosovë nuk gëzonin mundësi të barabarta ekonomike.

Kosova Republikë!

Trepça është e jona!

Poshtë tradhtarët!

Titulli i këngës: “Trepça jonë”

Kompozitor dhe orkestrues: Fahri Beqiri

Teksti: Fahri Beqiri

Këndon: Grupi i fëmijëve i Radio Televizionit të Prishtinës

Solistë: Meriton Berisha, Zana Badivuku, Vlora Grajçevci

Këngë pjesëmarrëse në Mbrëmjen për fëmijë të Akordeve të Kosovës 1981.

Publikuar në vitin 1985 në audio kasetën e parë me këngë për fëmijë nga Fabrika e kasetave e produksionit muzikor të Radio Televizionit të Prishtinës (RTP), Kosovë.

“Trepça jonë”

Trepça jonë, Trepça jonë
Këngën për ty e këndoj
Trepça jonë, Trepça jonë
Gjithmonë kënga le t’jehojë!

Trepça jonë e pasur
Na nxjerrë shumë metale
Tymin nga oxhaqet
Asnjëherë s’e ndale

Trepça jonë, Trepça jonë
Këngën për ty e këndoj
Trepça jonë, Trepça jonë
Gjithmonë kënga le t’jehojë!


Gjithmonë ke punuar
Kurrë nuk ke pushuar
Kosovën e dashur
Për t’a zbukuruar

Trepça jonë, Trepça jonë
Këngën për ty e këndoj
Trepça jonë, Trepça jonë
Gjithmonë kënga le t’jehojë!

Trepça jonë!

MARSHI I 17 NËNTORIT, 1988

Në proces të revokimit të autonomisë së Kosovës dhe nën presion të Beogradit, Komiteti Qendror i Lidhjes Komuniste të Kosovës ishte përgaditur të shkarkojë Azem Vllasin dhe Kaqusha Jasharin nga detyra, që të dy udhëheqës shqiptarë në Lidhjen Komuniste të Kosovës. Takimi i Komitetit ishte caktuar në mbrëmje të 17 nëntorit, 1988. Kjo i alarmoi minatorët dhe si kundërpërgjigje, në po të njëjtën ditë ata organizuan marshin nga Mitrovica në Prishtinë për të kundërshtuar shkarkimin e tyre, pensionimin e hershëm të stafit akademik dhe suprimimin e autonomisë së Kosovës.



17 nëntor, 1988

Minatorët e Trepçës u mbledhën në mëngjes në Stantërg dhe filluan marshin për në Prishtinë. Të veshur në uniforma, çizme dhe helmata, ata i ecën në këmbë 52 kilometra. Gjatë marshit, minatorët mbanin pankarta si: “Tito-Partia”, “Vllaznim, Bashkim, Barazi”, “Nuk pranojmë dorëheqje me presion, e as dorëheqje kolektive”, “Rroftë klasa punëtore”.

Me arritjen e tyre në Prishtinë, ata u mbledhën në Pallatin e Rinisë “Boro dhe Ramizi”. Kaqusha Jashari dhe Azem Vllasi, të cilët po atë ditë ishin shkarkuar nga Komiteti Qendror i Lidhjes Komuniste të Kosovës mbajtën fjalime.

Në intervistën e saj të historisë gojore, Kaqusha Jashari përshkruan:

“Më thirri në telefon drejtori Aziz Abrashi në zyre atë ditë para mbledhjes. Tha, ‘Mos gaboni me dhonë dorëheqje se po vijnë minatorët. Kanë vendos me ardhë’. ‘Jo,’ thashë, ‘me dhonë une jo, vetëm a më lirojnë prej detyrës, a më hekin nuk muj me garantu. Çka di une kur hapët diskutimi, po me dhonë dorëheqje jo’.

Kur mrrinën minatorët këtu, hinën në Pallatin e Rinisë. [...] Atëhere u murrëm vesh në Kryesi që e kemi udhëheqë mledhjen me ndërpre edhe atje me shku se po më kërkojnë. Edhe shkova atje, po më dokët që ka qenë me mu edhe Remzi Kolgeci, s’e di edhe kush, edhe ata nisoj për ato [kërkonin] mos me dhonë dorëheqje. Ato kërkesa që i kanë bo ma vonë kur ka qenë greva, ato nuk kanë qenë atëhere. Por tani kanë qenë vetëm në lidhje me dorëheqjet tona. Une thashë, ‘Nuk jepi dorëheqje.’”

FIG. 19, 20: Kaqusha Jashari dhe Azem Vllasi në stadionin e Prishtinës gjatë marshit të minatorëve, 17 nëntor, 1988. Fotografitë janë nga arkivi privat i Kaqusha Jasharit.









FIG. 21: Kaqusha Jashari duke mbajtur fjalim para minatorëve në Pallatin e Rinisë “Boro dhe Ramizi” në Prishtinë, më 17 nëntor, 1988. Fotografia është nga libri i Kaqusha Jasharit, “Do ta vendosim kufirin (1988–1989)”, botuar nga Koha, Prishtinë, 2015, f. 296.






FIG. 22, 23, 24: Fotografi nga marshi i minatorëve më 17 nëntor, 1988. Botuar në gazetën e përditshme në gjuhën shqipe "Rilindja", më 20 nëntor, 1988.

















Flamuri shqiptar dhe fotografia e liderit jugosllav Josip Broz Tito ishin simbolet që e prinë marshin e minatorëve të Trepçës më 17 nëntor, 1988, e më pas edhe grevën tetëditore në minierën e Trepçës, nga 20 deri 28 shkurt, 1989.

Në intervistën e tij të historisë gojore, Azem Vllasi përshkruan:

“Nëpër Prishtinë, nëpër qendër të Prishtinës kanë defilu njerëz me flamur jugosllav, flamurin tonë shqiptar të lidhuna me portretin e Titos. A e dini pse? Ajo ka qenë si porosi e opinionit jugosllav që nuk o t’u ndodh këtu kurrëfarë lëvizje armiqësore kundër Jugosllavisë dhe sistemit, por osht’ ftesë Jugosllavisë që të na mbron prej presioneve të Serbisë. Kjo osht’ lëvizje demokratike në kundërshtim të presioneve të Serbisë kundër kuadrave. Thojshin njerëzit, ‘Nëse nuk bojnë këta [kuadra], na nuk po bojmë be në këta kuadra. Por, nëse nuk bojnë, na i zgjedhim të ri. Por, jo Beogradi me na i ndrru’. Qaty ishte esenca.”

FIG. 25: Minatorët gjatë marshit nga miniera e Trepçës për në Prishtinë, më 17 nëntor, 1988. Fotografia është nga arkivi privat i Azem Vllasit.



FIG. 26: Fotografi nga marshi i minatorëve në Sallën e Sporteve “Boro dhe Ramizi” në Prishtinë, 17 nëntor, 1988. Botuar në gazetën e përditshme në gjuhën shqipe “Rilindja”, më 18 nëntor, 1988.





FIG. 27: Në fotografi janë minatorët e Trepçës në Sallën e Sporteve “Boro dhe Ramizi” në Prishtinë, më 17 nëntor, 1988. Fotografia është nga arkiva private e Azem Vllasit.





FIG. 28: Fotografi nga marshi i minatorëve më 17 nëntor, 1988. Faqja e internetit thealbanian.co.uk.





GREVA E MINATORËVE
20–28 SHKURT, 1989

Gjatë grevës tetë-ditore, minatorët kryesisht qëndruan në horizontin e tëtë dhe nëntë të minierës së Trepçës. Kërkesat e tyre nuk ishin sociale, por politike, dhe si të tilla kërkonin një zgjidhje politike. Nëntoka ishte hapësira ku përpjekjet politike të tyre po gjenin artikulum dhe një lokacion nga ku ata krijuan një marrëdhënie tjetër me atë që ishte duke ndodhur në sferën politike në vend.

20 shkurt, 1989

Komiteti Krahinor i Kosovës nuk iu përgjigj kërkesave të minatorëve të Trepçës të parashtruara më 17 nëntor, 1988. Andaj, më 20 shkurt, 1989 rreth orës 13:00, minatorët e ndërrimit të katërt nuk dolën fare nga miniera. Grevës iu bashkua edhe ndërrimi i parë, i dytë dhe i tretë.

Miniera e Trepçës është afër një mijë metra nën tokë dhe ka dymbëdhjetë horizonte. Horizonti i tetë ishte kryesori, pasi që aty gjatë grevës pranohehin përfaqësuesit politikë dhe mediat lokale dhe ndërkombëtare.

Në intervistën e historisë gojore, Avdi Uka përshkruan:

“Çka me bo zgjidhje, veç duhet me hi në grevë. Në sipërfaqe s’na lanë, hajde hinëm na minatorët, mes veti, une kom folë me ty, ti ke folë me këto, kjo ka folë me ato, *buu* {onomatope} mrena... Del ndërrimi i parë, del i dyti, vjen i tretë, vjen i katërti jonë tubu krejt, 1300 minatorë, tetë ditë e tetë netë.”

21 shkurt, 1989

Remzi Kolgeci, asokohe kryetari i kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome dhe Rrahman Morina, udhëheqës i Lidhjes Komuniste të Kosovës kishin marrur pjesë në kuvendin e Kombinatit Trepça të mbajtur në Mitrovicë.

Me situatën e krijuar, shumë ndërmarrje të Trepçës dhe ndërmarrje të tjera shoqërore, kishin ndalur prodhimin në solidaritet me grevën e minatorëve.

Kuvendi kishte vlerësuar se mjetet e përdorura nga ana e minatorëve për të parashtruar kërkesat e tyre, nuk do të kontribuojnë në stabilizimin e gjendjes politike, por rëndimin e saj.

Aziz Abrashi, drejtor i Kombinatit Trepça kishte zbritur në horizontin e tetë për të diskutuar me minatorët mundësinë që ta ndërprejnë grevën. Në minierë ishte bashkangjitur Remzi Kolgeci, por jo edhe Rahman Morina.

23 shkurt, 1989


Minatorët grevistë ua komunikojnë publikut të gjerë kërkesat e tyre. Në ndërkohë, ata kishin artikuluar edhe kërkesa të reja. Dy më kryesoret mbetën: garantimi i themeleve të Kushtetutës së Jugosllavisë të vitit 1974 dhe shkarkimi i Rahman Morinës, Hysamedin Azemit dhe Ali Shukriut.

FIG. 29: Minatorët në minierë gjatë grevës 1989. Fotografia është nga arkivi privat i Bahtije Abrashit.





FIG. 30: Minatorët në minerë gjatë grevës 1989. Botuar në gazetën e përditshme në gjuhën serbe "Jedinstvo", më 28 shkurt, 1989.






FIG. 31: Fotografi nga vizita e Remzi Kolgecit në minierë gjatë grevës së minatorëve.
Botuar në gazetën e përditshme në gjuhën serbe "Jedinstvo", më 22 shkurt, 1989.






FIG. 32 dhe 33: Nga vizita e Remzi Kolgecit, botuar në gazetën e përditshme në gjuhën shqipe "Rilindja", më 22 shkurt, 1989.









KËRKESAT E MINATORËVE

*Kërkesat e minatorëve u bënë publike në gazetën e përditshme në gjuhën shqipe "Rilindja", botuar më 24 shkurt, 1989.

1. Të mos preken parimet themelore të Kushtetutës së vitit 1974, por të bëhen aso ndryshimesh që vërtetë na çojnë përpara që na mundësojnë zhvillimin e mëtutjeshëm të vëllazërimit e bashkimit, të bashkëjetesës.
2. Të merren në përgjegjësi propozuesit e Projektligjit mbi pensionimet e parakohshme të punëtorëve të arsimit. Nëse ishte dashur të nxirret ndonjë ligj sipas përparësisë, atëherë ky ishte dashur të jetë Ligji mbi pensionimin e parakohshëm pikërisht të xehtarëve.
3. Të japin dorëheqje të parevokueshme Rrahman Morina si kryetar i Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës, Hysamedin Azemi, kryetar komunal i Lidhjes së Komunistëve dhe Ali Shukriu, anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Arsyet e argumentet për këtë le të vijnë t'i dëgjojnë nga goja jonë.

4. Të vijë në mesin e tyre Stipe Šuvar, Slobodan Milošević, dhe nga një përfaqësues i të gjitha komiteteve qendrore të Republikës së Serbisë dhe të Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Vojvodinës.
5. Të emërtohen organizatorët e tubimeve masive të xehtarëve në nëntorin e vjetëm. Nëse ka të tillë, atëherë jemi të gjithë ne xehtarët.
6. Të na jepet përgjigje pse u larguan nga funksioni që i patën shokët Azem Vllasi, Kaqusha Jashari dhe Svetislav Dolašević pa vlerësime të bazës.
7. Kërkojmë që udhëheqësit e Kosovës t'i zgjedhë baza, përkatësisht klasa punëtore e Kosovës e jo burokracia e republikave të tjera.
8. Kërkojmë që fati i shqiptarëve në Kosovë e Jugosllavi të shqyrtohet në Kombet e Bashkuara.
9. Hedhim poshtë politikën diskriminuese të Slobodan Milošević, e cila na largon nga rruga e drejtë e shokut Tito.
10. Njoftojmë strukturat krahinore, republikane e federative, por edhe mbarë opinionin se derisa të mos plotësohen kërkesat tona, ne nuk e kemi ndërmend të dalim nga horizontet e zgafellës së Xehrores së Stantërgut.

FIG. 34: Nga vizita e ekipit të Muzeut të Revolucionit, në minierë gjatë grevës së minatorëve. Të pranishëm, Dr. Riza Sadiku, Prof. Mehmet Gjosh, fotografi Dilaver Pepa.





FIG. 35: Fotografi nga dita e tretë e grevës së minatorëve, në horizontin e tetë të minierës, botuar në gazetën e përditshme në gjuhën shqipe "Rilindja", më 23 shkurt, 1989.







FIG. 36: Fotografi nga dita e katërt e grevës së minatorëve, botuar në gazetën e përditshme në gjuhën shqipe “Rilindja”, më 24 shkurt, 1989.





24 shkurt, 1989

Në ditën e pestë të grevës së minatorëve të Trepçës, pas orës 17:00, minierën e vizitoi Stipe Šuvar, në përcjellje të udhëheqësve të tjerë jugosllavë.

Atëbotë, Stipe Šuvar ishte përfaqësues i lartë në Lidhjen Komuniste të Jugosllavisë. Gjatë kësaj vizite, ai bashkëbisedoi me minatorët grevistë për dy orë të plota.

Ai kërkoi nga minatorët që të ndërpritet greva dhe premtoi që kërkesat e tyre do të shqyrtohen, përkundër faktit që nuk kishte disponim për një gjë të tillë nga ana e udhëheqësve të tjerë të lartë të Jugosllavisë.

Në intervistën e tij të historisë gojore, Xhafer Nuli përshkruan:

“Ka ardhë Stipe Šuvar, ka ardhë njëfarë Radiša Gačić edhe njëfarë Jurij Bajec kanë ardhë. Jonë mundu me i bind minatorët me dalë. Mirëpo, minatorët i kanë dhonë përgjigje shumë të kjartë edhe shumë asi... Bile, m’kujtohet fort mirë kur dul Stipe Šuvar tha, ‘Çka osht’ ai?’ Për një Mursel Hazirin. Mursel Haziri ka qenë grevist edhe ai edhe ka qenë i burgosun me këta grevostat ma vonë. Murseli tha, ‘Kush po i bon mitingjet në Vojvodinë?’ Tha, ‘Po thojnë populli. Kush po i bon mitingjet në Mal të Zi? Po thojnë populli’. Tha, ‘A na çka jemi?’ Ky meti s’diti çka m’i thonë. ‘Pse për neve s’bon e për ata bon?’ E kur dul tha, ‘Ky, çka osht’ ai, filani?’ ‘Xehtar’. I thanë. ‘Dom osht’ që ai është aty. Ai duhet m’u konë këtu me neve”, demek nuk osht’ ai për aty...”

FIG. 37 dhe 38: Fotografi nga vizita e Stipe Šuvar në minierën e Stantërgut gjatë grevës. Botuar në gazetën e përditshme në gjuhën serbe “Jedinstvo”, më 25–26 shkurt, 1989.









FIG 39: Fotografi nga konferenca për media, ku ishin të pranishëm Aziz Abrashi, Burhan Kavaja, Stipe Šuvar, Remzi Kolgeci. Botuar në gazetën e përditshme në gjuhën serbe "Jedinstvo", më 25 shkurt, 1989.





25 shkurt, 1989

Në ditën e gjashtë të grevës së minatorëve të Trepçës, minierën e vizitoi Azem Vllasi, edhe pse ai tashmë nuk mbante një pozitë zyrtare. Mirëpo, i shqetësuar që vizita e Šuvarit nuk kishte prodhuar ndonjë rezultat, kishte vendosur që t'i vizitojë minatorët.

Në nëntor të vitit 1988, Vllasi u shkarkua nga pozita e kryetarit të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, vendim ky që destabilizoi gjendjen politike e shoqërore në Kosovë.

Marshi i minatorëve nga Mitrovica në Prishtinë, më 17 nëntor, 1988, ishte kundër largimit të kuadrove shqiptare nga pozitrat udhëheqëse.

Në intervistën e historisë gojore, Azem Vllasi përshkruan:

“Ajo më preki mu si njeri. S’po muj, a beson... {pauzon}. Tash qata njerëz janë që më kanë përkrahë mu në nëntor [1988]. Qata njerëz jonë, e di çfare jonë, kush jonë. Kurrë një kërkesë, diçka të papranueshme armiqësore as kundër. Thashë, ‘Vetëm të shkoj t’i shoh’. Nuk kisha unë autorizime me thonë, ‘Çka po kërkoni, a mundet?’ Jo, t’i shoh si njerëz [...] Thashë, ‘Bahri, du me shku’. ‘Edhe unë du me shku me ty’. E shkumë bashkë. Qëlloi me mu [Bahri Oruçi], e që ja pa sherrin se ato tani e murrën në burg (buzëqesh). [...] E pamë një atmosferë të tmerrshme, kurrë s’e harroj në jetën teme. Nuk u dike a osht’ ai ambienti shkëmbinjët e minierës apo fytyrat e njerëzve.”

FIG. 41: Fotografi nga greva e minatorëve, botuar në gazetën e përditshme në gjuhën shqipe "Rilindja", më 27 shkurt, 1989.





26 shkurt, 1989

Në ditën e shtatë minierën e vizitoi Bajram Selani dhe Hashim Rexhepi, që të dy anëtarë të kryesisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Minatorët kërkuan vendime konkrete, pasi që me premtime ishin ngopur.

E vetmja kërkesë që mund të adresohet ishte Projektligji mbi pensionimin e parakohshëm të punëtorëve të arsimit. Takimi kishte zgjatur gjashtë orë.

Megjithatë, minatorët në krye me Aziz Abrashin kishin kërkuar kohë të mendojnë më me kujdes rreth projektligjit të propozuar. Ata kishin kërkuar konsultime me ekspertë të cilët do të zbërthenin më tutje çështjet kontestuese të ndryshimeve kushtetuese.

Në lidhje me grevën, hapat e ardhshëm do t'i merrnin vetëm duke u konsultuar me minatorët e minierave të tjera.


27 shkurt, 1989


Në ditën e tetë të grevës, rreth orës 19:00, minatorët kishin pranuar lajmin që kërkesa e tyre për dorëheqjen e Rrahman Morinës, Hysamedin Azemit dhe Ali Shukriut nga pozitat udhëheqëse ishte plotësuar.

Me plotësimin e kërkesës, greva tetë-ditore e minatorëve ndërpritet. Rreth orës 21:00, 1300 minatorët filluan të dalin nga miniera.

Në intervistën e tij të historisë gojore, Xhafer Nuli përshkruan:

“Dokumenti i vulosun nga Kuvendi Krahinor i Kosovës supozohej të ishte i vërtetë. Mirëpo, pas daljes së minatorëve nga miniera, kuptohet të ishte vetëm një mashtrim me qëllim që të e ndalonte grevën. [...] Veç nënshkrimin ia kanë dhonë që po jep dorëheqje. I kanë thonë, ‘Jo veç nënshkrimin, por shko e dojmë me myhyrë!’ I thojke (qesh), ‘Me vule’. Ja kanë pru, e kanë vulos edhe e kanë pru dorëheqjen, mirëpo ajo ka qenë krejt mashtrim. Kurrëfarë dorëheqje mandej nuk u apliku. Mandej veç kanë fillu represalet.”





Qëndrimi i minatorëve në zgafellën e minierës gjatë grevës u kishte shkaktuar probleme të ndryshme shëndetësore. Shumë prej tyre morën trajtim nga mjekët e organizatës së Trepçës dhe të tjerë, të cilët kishin ngritur një stacion mjeksor në menzën e minatorëve.

Në intervistën e tij të historisë gojore, Faik Bllata përshkruan:



“Une me shumë mjekë, me doktor Ademin, me plot mjekë. Ka pasë edhe mjekë që kanë pasë Trepça të vet atje. E maj mend ditën e parë kom shku, kemi zbritë me lift në horizontet e Trepçës. Nuk osht’ ndjenjë e mirë me hi në lift, me zbrit 700—800—900 metra poshtë në zgafellë. Mirëpo, gjithë e kisha në mendje me shku me ju ndihmu atyne minatorëve. Unë kom qenë mjek i punëtorëve në vitet e ‘80—ta e tanë minatortë më njofshin. U gëzunë shumë. Mora ni çantë barna, [siç] ju thashë që në atë kohë kanë qenë barnat pa pare edhe kontrollimet e krejt. Rezervumë barna të mjaftueshme, antibiotik kundër temperaturës, kundra kollit, kundra vjelljes, kundra helmimit. Edhe me çantë plotë barna i kom kontrollue. Po ditët e para, dy-tri ditët e para nuk ka pasë probleme shëndetësore. Tek ma vonë fillunë se kish minatorë edhe të moshum, po edhe me sëmundje kronike. Se me punue brenda në minierë e m’i pasë mushknitë e mira ose shtypjen e mirë osht’ rast i rrallë. [...] Gjendja e tyre shëndetësore osht’ keqësu, kur i kemi thanë që duhet gjithsesi me dalë prej minierës, ata s’kanë dashtë. Kanë thanë, ‘Veç i vdekun! Katër vetë munën me më qitë e me m’nda prej shokëve që janë grevistë.’”

FIG. 42: Qytetarët e Prishtinës duke dhënë gjak për minororë grevistë.
Libri "555 ...: kronikë (1981-1995)", nga Ilaz Bylykbashi, 1996, f. 66.



FIG. 43: Spitali i improvizuar gjatë grevës. Libri “555 ...: kronikë (1981–1995)”, nga Ilaz Bylykbashi, 1996, f. 65.





28 shkurt, 1989

Për të mos e dëmtuar të pamurit, dalja nga miniera e 1300 minatorëve grevistë ishte organizuar natën.

Në intervistën e tij të historisë gojore, Avdi Uka përshkruan:


“Kur ardhshin mjekët me na kontrollue, me na asi... thojshin, ‘Kur dilni përjashtë muni me hup pamjen, se atje [në zgafellë] terr me ato llamat asi... e kur dilni përjashtë o rrezik puna e syve...’ Po, nejse, kur dolëm përjashtë nëpër spitale u çkepëm do që ishim të smutë llom, mu më çunë në Mitrovicë spital, s’kom ditë. Edhe qashtu e prunën vendimin, ato mjekësia e ka pru me i qitë ato farë {mbulon sytë} faculetat... fashat, po me i qitë në sy deri te merr pak pamjen e jashtit, pak qitu {përshkruan me dorë} në ballë që me pa kapak dritë. E qashtu erdhë puna edhe dulëm me 28—in [shkurt].”

FIG. 44 dhe 45: Minatorët në përfundim të grevës duke dalur nga horizonti i nëntë i minierës. Botuar në gazetën e përditshme në gjuhën shqipe "Rilindja", më 28 shkurt, 1989.









APELI I FUNDIT NGA HORIZONTI I TETË:
LE TË PAJTOHEN GJAQET

“Ne minatorët e Stari-Tërgut të cilët jemi të mbyllur nën tokë çet ditë pa e pa dritën e djellit me sy, pa ngran e pa pi, me gzim të madh ndëgjuam lajmin për një gjest human të traditës shqiptare. Fjala është për pajtimin e familjeve Haxhi Bytyqi dhe Sejdi Ramshi. Apeli i Xehetarëve të Trepçës dhe mbarë Kosovës, të gjitha familjet e gjaksuar mes veti është tja shtrijnë si burrat dorën njeri tjetrit dhe të pajtohen, si thojnë populli besën e paçës. Kjo kishte me çenë ushqimi jon, drita jon, kishte me çenë përkrahja ma e madhe për neve. Të ndërpritet vlla vrasja.”

*Apeli u bë publik në gazetën e përditshme në gjuhën shqipe “Rilindja”, të botuar më 27 shkurt, 1989.

1 mars, 1989

Një ditë pas përfundimit të grevës të minatorëve së Trepçës, organet jugosllave morën vendim për mbylljen e minierës dhe burgosjen e personave të cilët cilësoheshin si organizatorë të grevës.

Edhe pse greva kishte strukturë organizative horizontale, pesëmbëdhjetë prej tyre u arrestuan dhe u mbajtën në burg për katërmëdhjetë muaj për veprimtari kundërrevolucionare.

Të arrestuarit ishin: Burhan Kavaja, Aziz Abrashi, Ibush Jonuzi, Mensur Fejza, Riza Musliu, Avdi Uka, Veli Osmani, Tahir Salihu, Jetish Bajrami, Ismajl Nimani, Ramiz Kadriu, Mursel Haziri, Sinan Kurteshi, Lazër Krasniqi dhe Azem Vllasi.

Dy të fundit nuk ishin pjesë e grevës, mirëpo ishin shënjestruar nga Sekretariati i Punëve të Brendshme për shkak të mbështetjes publike që ia kishin dhënë grevës.

Në intervistën e tij të historisë gojore, Burhan Kavaja përshkruan:

“Natën më kanë marrë rreth orës 22:00, pa lonë mundësi m’u vesh qysh duhet. Më kanë dërgu në Sekretariat të Punëve të Brendshme të Prishtinës, prej atyhit për Mitrovicë. Gjithë natën më kanë majt zgjutë. Nesrit gjithë ditën më kanë majt zgjutë. Kuptohet, nuk pytshin veç që s’më lojshin me flejt edhe qaty rrishin. Aty më ra m’i pa të gjithë ata që në njëfarë mënyre i kom pa, e s’kom ditë që kanë punu në policinë sekrete. Në mramje, ‘Në emën të popullit je i burgosun!’ M’i vnun... po u mbledhshin gjashtë, shtatë policë edhe përnjiherë të gjithë po bërtitshin ‘Je i burgosun!’ Krejt. Edhe po të rrethojnë edhe po t’i vnojnë [prangat].”

FIG. 46: "Aktorët e Procesit të Montuar Politik". Grupi i arrestuar i minoritëve dhe udhëheqësve të Kombinatit, dhe përfaqësuesve politikë. Botuar në revistën e studentëve të Universitetit të Prishtinës, "Bota e Re", 14 maj, 1990.

AKTORËT E PROCESIT TË MONTUAR POLITIK










 <p>Aziz Abrashi</p>	 <p>Burhan Kuvaja</p>	 <p>Llazër Krasniqi</p>	 <p>Meneur Fejza</p>
 <p>Ruzhë Vojvoda</p>	 <p>Riza Mushi</p>	<p>Mursel Haziri nuk desh të fotografohet në një faqe gazeteme Azem Vilasin</p>	 <p>Ismail Nisani</p>
 <p>Avdi Uka</p>	<p>FAQEN E PËRGATITI: MUHARREM MJEKU</p>	 <p>Veli Osmani</p>	 <p>Tahir Salihu</p>
 <p>Jashari Bajrami</p>	 <p>Bënan Kurtishi</p>	 <p>Remiz Kadriu</p>	 <p>Azem Vllasi</p>

Foto: e re 16 MAJ 1990

23 mars, 1989

Kuvendi i Kosovës votoi ndryshimet në Kushtetutën e Jugosllavisë që do suprimonin autonominë e Kosovës, duke e kthyer atë nën pushtetin politik të Beogradit. Votimi u bë në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme që ishte vendosur 20 ditë më herët.

27 tetor, 1989

Organizohet greva e urisë në minierën e Trepçës për të shprehur pakënaqësi rreth arrestimit të minatorëve, drejtorit të minierës me flotacion të Stantërgut dhe drejtuesit të Kombinatit të Trepçës.

Në grevën katër-ditore në horizontin e tetë morën pjesë mbi gjashtëdhjetë minatorë.

Në intervistën e tij të historisë gojore, Ramadan Gjeloshi përshkruan:

“U ulëm, po kqyrëm, mirë. Jena konë, na hinëm veç të funit, jena konë 62. Edhe u nalëm, kur u bo dy orë, kur u bo dy orë Qazim Shala u konë drejtor i dhunshëm. [...] Edhe erdh Qazim Shala, me dy inxhinierë, me ni mjek, erdhën poshtë, ‘Kqyre djem’, tha, ‘une jom ardhë sot këtu te ju, po ju luti deri në këtë moment’, ish 5:00 sahati në aksham, 6:00. Thotë, ‘Po ju garantoj kush del me mu qetash’, thotë, ‘ni kime e flokëve s’ka me ju *falit* [srb.: mungu], ai masanej që rrin e s’del me mu keni m’u shpallë tjetër emër’. Tani dikush tha, ‘A terrorista neve po don me na shpallë a? Ti je drejtor i joni?’ E anej-knej e shajtën edhe u çunë do dolën me to. 62 minatorë metëm, të koçitë. [...] u çumë, po i ngjehum 62, tonë janë. ‘Djem, kush osht’ pishmanli apo osht’ diçka pa qef? Dilni, nisnu me ata!’ ‘Jo, une s’dal!’ Ai, ‘S’dal!’ Ai, ‘S’dal!’”

Me përjashtimin nga puna të minatorëve në fillim të viteve 1990, ata krijuan Sindikatën e Pavarur të Minatorëve, e cila përkujdesej të gjente punë për minatorët dhe të siguronte ndihma për ta.

Akcioni Familja Ndhmon Familjen, një nismë që mori hov gjatë Fushatës së Pajtimit të Gjaqeve, krijoi lidhje ndërmjet familjeve të minatorëve dhe familjeve nga anët e ndryshme të Kosovës. Këto të fundit i punësonin ose u dërgonin ndihma.

Deri në shtator të vitit 1990, në tërë Kosovën punëtorët shqiptarë që punonin në ndërmarrje të ndryshme shoqërore u përjashtuan nga puna, nxënësit nga shkollat dhe studentët dhe stafi akademik nga universiteti. Ky kontekst politik i njohur si periudha e regjimit të Milošević-it zgjati deri në vitin 1999.

SHËNIME

1. Figurat, hartat, fotografitë, ilustrimet janë përdorur për të lehtësuar leximin e informacionit. Në mungesë të dokumenteve dhe fotografive origjinale kemi përdorur materiale vizuale nga gazetat e përditshme të kohës, studime, libra, burimi i të cilave është i listuar në secilën figurë.
2. Për të ofruar informacion rreth vendburimeve të mineraleve në minierën e Trepçës, në Figurën 7 kemi adaptuar bllokdiagramin e punuar nga Hashim Këpuska, 1998.
3. Intervistat e cituara janë realizuar nga Iniciativa për Histori Gojore dhe forumZFD programi në Kosovë gjatë periudhës 2020-2022, dhe të gjitha janë publikuar dhe të qasshme në arkivin online. Gjatë periudhës dy—vjeçare të hulumtimit, mbi njëzet intervista u realizuan me minatorë, punonjës të kombinatit Trepça, avokatë, gjygtarë, mjekë, politikanë, gazetarë dhe familjarë të minatorëve. Shih arkivin: oralhistorykosovo.org/sq/hulumtime/miners-strike-1989-2/
4. Kaqusha Jashari, intervista e realizuar nga Iniciativa për Histori Gojore dhe forumZFD programi në Kosovë, Prishtinë, 02.07.2021
oralhistorykosovo.org/sq/kaqusha-jashari/; 08.03.2022
5. Avdi Uka, intervista e realizuar nga Iniciativa për Histori Gojore dhe forumZFD programi në Kosovë, Vushtrri, 20.05.2021
oralhistorykosovo.org/sq/avdi-uka/; 03.03.2022
6. Azem Vllasi, intervista e realizuar nga Iniciativa për Histori Gojore dhe forumZFD programi në Kosovë, Rubofc, 23.07.2021
oralhistorykosovo.org/sq/azem-vllasi/; 03.03.2022
7. Burhan Kavaja, intervista e realizuar nga Iniciativa për Histori Gojore dhe forumZFD programi në Kosovë, Prishtinë, 30.10.2020
oralhistorykosovo.org/sq/burhan-kavaja/; 03.03.2022
8. Ramadan Gjeloshi, intervista e realizuar nga Iniciativa për Histori Gojore dhe forumZFD programi në Kosovë, Stantërg, 25.05.2021
oralhistorykosovo.org/sq/ramadan-gjeloshi/; 03.03.2022
9. Xhafer Nuli, intervista e realizuar nga Iniciativa për Histori Gojore dhe forumZFD programi në Kosovë, Mitrovicë, 21.10.2020
oralhistorykosovo.org/sq/xhafer-nuli/; 03.03.2022
10. Faik Bllata, intervista e realizuar nga Iniciativa për Histori Gojore dhe forumZFD programi në Kosovë, Vushtrri, 27.07.2021
oralhistorykosovo.org/sq/faik-bllata/; 11.11.2022

11. Abrashi, Aziz, dhe Kavaja, Burhan. “Epopeja e Minatorëve”, botuar nga shtypshkronja “Koha”, Prishtinë, 1996.
12. Amnesty International Publications, “Yugoslavia Prisoners of Conscious”, botuar nga Shadowden Limited, Londër, 1985.
13. Brajović, Petar, Islami, Nehat, Kurteshi, Ilaz, Ristić, Dušan, Stavileci, Esat, dhe Šešlija, Milan. “Kosovo”, botuar nga Gazeta Borba, Boal Ekonomska Politika, gazeta Jedinstvo dhe Boal Publishing, Prishtinë, 1982.
14. Bylykbashi, Ilaz. “555 ...: kronikë (1981 — 1995)”, botuar nga ndërmarrja “Rilindja”, Prishtinë, 1996.
15. Clark, Howard. “Civil resistance in Kosovo”, botuar nga Pluto Press, Londër, 2000.
16. Dauti, Daut. “Lufta për Trepçën (sipas dokumenteve britanike)”, botuar nga KIEAI, Prishtinë, 2002.
17. Dushi, Minir. “Shtigjeve të jetës sime: Kujtime e përjetime dhe shënime biografike e bibliografike”, botuar nga Shoqata e Intelektualëve “Jakova”, Prishtinë, 2018.
18. Haziri, Mustafë. “Greva e Minatorëve të Trepçës në Stantërg”, botuar nga Lidhja e Historianëve të Kosovës “Ali Hadri”, Prishtinë, 2011.
19. Magaš, Branka. “Yugoslavia: The Spectre of Balkanization”, botuar në New Left Review. Nr. 174, mars dhe prill, 1989.
20. Malcolm, Noel. “Kosovo: A Short History”, botuar nga Macmillan Papermac, London, 1998.
21. Palairt, Michael. “Trepça, 1965—2000”, Lessons Learned and Analysis, Unit of the EU Pillar of UNMIK in Kosovo. Hulumtimi i realizuar në Beograd, Zvecan, dhe Edinburg, nga korriku 2002 deri qershor 2003.
22. Sutaj, Ali. “Rilindja 1945—1985 (Tekste për monografi)”, botuar nga ndërmarrja “Rilindja”, Prishtinë, 1985.
23. Ristić, Ivan, red. “Bogdan Bogdanović: Memoria und Utopie in Tito—Jugoslawien”, botuar nga Architekturzentrum Wien, Austri, 2009.

HAPËSIRA TË PËRPRJEKJES POLITIKE:
MINIERA E TREPÇËS 1989

Muzeu Kombëtar i Kosovës
1—28 shkurt, 2023

Redaktuar nga
Erëmirë Krasniqi

Hulumtuar nga
Renea Begolli, Anita Susuri, Korab Krasniqi dhe Erëmirë Krasniqi

Dizajnuar nga
Nita Salihu Hoxha— Studio Permanent

Ilustruar nga
Elvira Thaqi—Studio Permanent
(f. 14-17, 22-23)

Shtypur nga
Shtypshkronja Iliri

Botuar nga
Iniciativa për Histori Gojore

©2023

Hulumtimi dhe ekspozita mbi Grevën e Minatorëve 1989 është realizuar në partneritet ndërmjet Inicativës për Histori Gojore dhe forumZFD programi në Kosovë, me mbështetje përmes fondeve të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Ky publikim është mbështetur nga Foundation for Art Initiatives.





Katalogimi në botim (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës - Pjetër Bogdani

061:94(496.51)

Hapësira të përpjekjes politike : miniera e Trepçës 1989 /
redaktuar nga Erëmirë Krasniqi. -
Prishtinë : Iniciativa për Histori Gojore, 2022. - 133 f. ; 22 cm.
Trepça (Kosovë) -- Historia -- Ekspozitat

ISBN 978-9951-776-04-2
Aleph [000105373]

